REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. k5/f2 - 12 **Prot.**
Nr. Dok. 202503476/12

Tiranë 20 / 1 **/2026**

Lënda: *Rekomandim për marrjen e masave nga Bashkia për aplikim me prioritet për financim të projektit të ndërtimit të institucionit arsimor*

BASHKISË DIMAL

DIMAL

Të nderuar,

Në mbështetje të nenit 13, të ligjit nr. 8454 datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, Avokati i Popullit filloi procedurën për shqyrtimin e rastit konkret, pas marrjes dijeni nga ankesa e disa qytetarëve, banorë në Njësinë Administrative Kutalli, Bashkia Dimal. Banorët në ankesat e tyre ngrenë shqetësimin lidhur me shkollën në fshatin Donofrosë, e cila qëndron e mbyllur që prej tërmetit të vitit 2019. Nxënësit e këtij institucioni arsimor, prej 6 vitesh, zhvillojnë procesin mësimor në një lokal të përshtatur si shkollë. Klasat ku nxënësit zhvillojnë mësimin janë të ndara me perde ose me kompensata, ç'ka e bën të pamundur përqëndrimin e tyre në orën mësimore. Disa banorë, nisur nga kjo problematikë kanë gjetur si zgjidhje për arsimimin e fëmijëve dërgimin e tyre në një shkollë private në bashkinë Roskovec, por kjo gjë shton barrën financiare të këtyre familjeve.

Sipas raportimit në media nxënësit së bashku me prindërit e tyre kanë protestuar, duke pretenduar se organet e administratës publike përgjegjëse, Bashkia Dimal dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk marrin përsipër financimin e shkollës së re.

Avokati i Popullit filloi hetimin administrativ për këtë rast të bërë publik, duke kërkuar informacion zyrtar nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar

Korçë[1], Bashkia Dimal[2], Ministria e Arsimit[3], Fondi Shiptar i Zhvillimit[4], dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile[5].

Në vlerësim të përgjigjeve të shkresave "Kërkesë për informacion", drejtuar institucioneve të lartë përmendura, jemi informuar si vijon:

Bashkia Dimal, nëpërmjet shkresës me nr.1138/5 prot., datë 30.09.2025 na bën me dije se ky institucion i është përgjigjur thirrjes së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit "*Për financim të projekteve të reja me cikël financimi 2025-2026*" me shkresën me nr. 183/1 prot., datë 01.02.2024, të cilën e kanë shoqëruar edhe me projekt-preventivin e shkollës, por kjo kërkesë është **refuzuar**.

Ministria e Arsimit, nëpërmjet shkresës me nr. 6364/1 prot., datë 24.10.2025 informon se ky institucion mbështet financimin e projekteve të infrastrukturës shkollore, në bazë të fondeve alokuar nga buxheti i shtetit si dhe masën e fondeve buxhetore të miratuara me ligjin nr.115/2025 "Për buxhetin e vitit 2025", për financimin e rikonstruksionit/ndërtimit të objekteve arsimore me cikël financimi 2025-2026".

Ministria e Arsimit ka miratuar për qarkun Berat disa shkolla me anë të Urdhrit nr.132, datë 2.4.2025, "Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, me cikël financimi 2025-2026, nga programet "Arsimi Bazë", "Arsimi i Mesëm" dhe programi "Për Sportin", për infrastrukturën shkollore e sportive".

Ndaj, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Bashkia Dimal ka mundësinë që pas shpalljes së thirrjes nga Ministria e Arsimit, të aplikojë sipas drejtimit të thirrjes, me projektin e plotë dhe preventivin për rikonstruksionin/ndërtimin e objekteve shkollore, pranë sekretariatit teknik në Ministrinë e Arsimit.

---

[1] Shkresa me nr. K5/F2-2 prot., datë 24.09.2025 e institucionit të Avokatit të Popullit
[2] Shkresa me nr. K5/F2-3 prot., datë 24.09.2025 e institucionit të Avokatit të Popullit
[3] Shkresa me nr. K5/F2-7 prot., datë 06.10.2025 e institucionit të Avokatit të Popullit
[4] Shkresa me nr. K5/F2-9 prot., datë 03.11.2025 e institucionit të Avokatit të Popullit
[5] Shkrese me nr. K5/F2-10 prot.,datë 25.11.2025 e institucionit të Avokatit të Popullit

Po kështu, bazuar në komunikimet e Fondit Shqiptar të Zhvillimit[6] dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile[7], rezulton qartësisht gadishmëria dhe disponibiliteti i këtyre institucioneve për të mbështetur financiarisht dhe teknikisht ndërtimin e shkollës "Haxhi Rustem" në fshatin Donofrosë, në momentin që krijohen kushtet e nevojshme buxhetore dhe hapen thirrjet përkatëse për aplikim. Institucionet konfirmojnë se ndërhyrja mund të merret përsipër për financim, me kusht që Bashkia Dimal të depozitojë brenda afateve të përcaktuara dokumentacionin e plotë teknik, përfshirë projekt-zbatimin, preventivin dhe specifikimet teknike. Në këtë kuadër, kërkesa mbetet e vlefshme dhe në shqyrtim për periudhat e ardhshme buxhetore, duke reflektuar një angazhim të qartë institucional për realizimin e këtij investimi sapo të sigurohen instrumentet e nevojshme të financimit.

Ekzistenca e mjediseve të përshtatshme shkollore përbën një nga shtyllat themelore të zhvillimit shoqëror dhe garantimit të së ardhmes së një kombi. Shkolla nuk është thjesht një godinë fizike, por hapësira ku formohen vlerat qytetare, zhvillohet mendimi kritik dhe ndërtohen aftësitë që përcaktojnë të ardhmen e fëmijëve dhe, për rrjedhojë, të shoqërisë në tërësi. Mungesa ose dëmtimi i rëndë i këtyre mjediseve, veçanërisht si pasojë e fatkeqësive natyrore, cenon drejtpërdrejt procesin e të nxënit, sigurinë fizike dhe psikologjike të nxënësve, si dhe barazinë në akses ndaj arsimit cilësor, duke prodhuar pasoja afatgjata sociale dhe ekonomike.

Banorët[8], pavarësisht depozitimit të ankesës së tyre pranë institucionit të Avokatit të Popullit në fillim të vitit shkollor 2025–2026, kanë kontaktuar sërish institucionin tonë gjatë këtij viti kalendarik, duke riafirmuar se problematika e ngritur vijon ende dhe është përkeqësuar më tej. Situata është bërë veçanërisht

---

[6] Fondi Shqiptar i Zhvillimit nëpërmjet shkresës me nr. 4458/1 prot., datë 10.11.2025 pohon se, "..... Fondi Shqiptar i Zhvillimit operon në zbatim të Programit të tij Operacional, i cili është një instrument programor zhvillimor me fokus territorial që garanton orientimin e investimeve dhe ndërhyrjeve në përputhje me vizionin "Shqipëria 2030". Ky program është një dokument planifikimi, i cili organizon në një plan operacional 7 vjeçar objektivat strategjike të institucionit, politikën e Qeverisë Shqiptare për Zhvillimin social-ekonomik, drejtimet e zhvillimit rajonal dhe kohezionit, siç janë përcaktuar në Ligjin nr. 102/2020, si dhe programet aktive në zbatim dhe ato të dakorduara. Programi Operacional i FSHZH-së, ka përcaktuar 5 drejtimet kryesore ku fokusohen ndërhyrjet transformuese nga FSHZH në përmbushje të objektivave strategjike të zhvillimit rajonal. Ndërhyrjet e parashikuara dhe vlerat përkatëse për këto ndërhyrje miratohen me Vendim të Këshillit Drejtues të institucionit dhe konfirmohen nga Ministria e Financave".

[7] Agjencia Kombëtare të Mbrojtjes Civile nëpërmjet shkresës me nr.2142/2 prot., datë 15.12.2025 pohon se, "..... Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, në kuadër të marrjes së masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive në infrastrukturën e dëmtuar, si dhe në veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile, merr përsipër investimin e projekteve të plota dhe të sakta, të hartuara nga subjekte private të liçensuara ose nga Instituti i Ndërtimit, të depozituara me kërkesë të njësive të qeverisjes vendore.Për sa më sipër, me qëllim shmangien dhe mënjanimin e çdo emergjence të mundshme civile, nga ana e institucionit tonë, kërkohet disponimi i projekt-zbatimeve, preventivave dhe specifikimeve të sakta teknike, si rrjedhojë materialet teknike duhet të përcillen sipas intervalit kohor të parashikuar në shpalljen e thirrjes për aplikim, që mund dhe pritet të përcaktohet për vitin pasues.

[8] Z. Fitim Dushku, z.Namik Çela, z. Renato Metohu, z. Aleks Dushku, z. Refit Xhaxho, z. Krenar Ripaj, z. Shaban Metohu, z. Guxim Sinjari, z. Daniel Dushku, z. Panajot Dushku dhe z. Renato Hoxha.

shqetësuese për shkak të stinës së dimrit, pasi mjediset ku zhvillohet procesi mësimor rezultojnë të papërshtatshme dhe nuk plotësojnë kushtet minimale për zhvillimin normal të mësimit.

Në këtë kontekst, marrja e masave të menjëhershme dhe efektive nga institucionet përgjegjëse paraqitet e domosdoshme, jo vetëm për zgjidhjen e situatës konkrete, por edhe për garantimin e respektimit të detyrimeve ligjore që lidhen me sigurimin e kushteve të përshtatshme për arsimin parauniversitar. Ndërhyrja në përmirësimin e mjediseve shkollore është thelbësore për të siguruar vazhdimësinë e procesit mësimor, për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës dhe për të parandaluar përkeqësimin e mëtejshëm të situatës.

Këto të drejta gjejnë mbështetje të qartë në kuadrin ndërkombëtar dhe legjislacionin vendas. Konventa për të Drejtat e Fëmijës sanksionon të drejtën e çdo fëmije për arsim dhe për zhvillim të plotë të potencialit të tij, duke i detyruar shtetet palë të sigurojnë kushte të sigurta, dinjitoze dhe të përshtatshme për procesin arsimor. Po ashtu Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (Pakti), i miratuar nga Kombet e Bashkuara, parashikon detyrimin e shteteve palë për të garantuar realizimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore të çdo individi, përfshirë të drejtën për arsim cilësor, të qasshëm dhe të barabartë për të gjithë.

Në këtë kuadër, Republika e Shqipërisë, si shtet palë e Paktit, duhet të sigurojë kushte të përshtatshme për zhvillimin e procesit arsimor, duke përfshirë, ndër të tjera, dhe **sigurimin e infrastrukturës shkollore të sigurt dhe funksionale**, që mundëson zhvillimin normal të mësimit dhe garanton sigurinë fizike dhe psikologjike të nxënësve.

Respektimi i detyrimeve të përcaktuara nga Pakti lidhet drejtëpërdrejtë me të drejtën e fëmijëve në Republikën e Shqipërisë për të përfituar një arsim cilësor, duke garantuar:

- ambient mësimor të përshtatshëm dhe të sigurt,
- mundësi për zhvillim të plotë të potencialit të tyre,
- mbrojtje nga çdo formë diskriminimi apo pengesë në qasje ndaj arsimit.

Çdo vonesë ose mosveprim në përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe në zbatimin e planifikimeve buxhetore që sigurojnë arsim cilësor për fëmijët përbën cenim të të drejtave të garantuara nga ky Pakt dhe nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Në të njëjtën linjë, legjislacioni shqiptar dhe politikat publike në fushën e arsimit dhe mbrojtjes së fëmijëve e konsiderojnë infrastrukturën shkollore të sigurt dhe funksionale si parakusht për realizimin efektiv të së drejtës për arsim.

Në këtë kontekst, mosfunksionimi ose mungesa e godinave shkollore të përshtatshme, veçanërisht në rastet e objekteve të dëmtuara nga tërmetet apo fatkeqësi të tjera natyrore, përbën jo vetëm një problem infrastrukturor, por një shkelje të drejtpërdrejtë të të drejtave të fëmijëve dhe një rrezik serioz për realizimin e të drejtës për arsim. Investimi në rindërtimin dhe përmirësimin e mjediseve shkollore është, në këtë kuptim, një detyrim ligjor, moral dhe shoqëror, që synon mbrojtjen e fëmijëve, garantimin e një procesi mësimor cilësor dhe ruajtjen e vlerave themelore mbi të cilat ndërtohet e ardhmja e vendit.

Standardet e BE-së mbi të drejtën për arsim, të sanksionuara në Nenin 14 të Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore, përcaktojnë që të gjithë kanë të drejtë për arsim me shkollim të detyrueshëm falas dhe akses të barabartë në trajnim profesional, ndërsa Protokolli 1 Neni 2 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (i përfshirë nëpërmjet ligjit të BE-së) kërkon që shtetet të sigurojnë arsim efektiv. Mësimi efektiv kërkon infrastrukturë të përshtatshme shkollore për të ofruar mësimdhënie cilësore pa diskriminim, pasi ndërtesat e papërshtatshme apo mungesa e tyre cenojnë mundësitë e të nxënit dhe krijojnë kushte për margjinalizim, duke shkelur parimet e përfshirjes që promovohen nga raportet e Këshillit të Evropës dhe politikat e barazisë së BE-së. Mungesa e infrastrukturës së duhur shkollore pengon drejtpërdrejt aksesin në shkollë duke krijuar hapësira të pasigurta ose të pamjaftueshme, duke shkelur detyrimet për akses jodiskriminues dhe duke çuar në përjashtim de facto nga arsimi, veçanërisht të grupeve vulnerabël si fëmijët[9].

Autoritetet publike dhe jopublike duhet të kenë në konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren në lidhje me ta[10]. Roli i arsimit është parësor për çdo vend që synon një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, kulturor dhe social. Kësisoj, komponenti i arsimit dhe edukimit gjatë gjithë jetës, është vendimtar në ndërtimin e një shoqërie të denjë.

Institucionet kanë detyrimin të sigurojnë që fëmijët dhe të rinjtë të trajtohen si duhet në shkollë dhe të drejtat e tyre njerëzore të mos shkelen, kjo me qëllim ofrimin e kushteve dhe mjediseve të përshtatshme të shëndetshme dhe të sigurta për realizimin nga fëmijët/nxënës jo vetëm të procesit mësimor por edhe të veprimtarive me karakter sportiv, edukativ, kulturor e dëfryes, në mjediset shkollore, në përshtatje me moshën e tyre[11].

Ekzistenca e godinës dhe mirëfunksionimi i mjediseve të brendshme të saj, me organizimin e duhur, mjetet dhe pajisjet e duhura dhe të nevojshme, është

[9] https://www.inclusion-europe.eu/the-right-to-education-is-a-fundamental-human-right/
[10] Pika 2, e nenit 6, të ligjit 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".
[11] Shkronja "c", e pikës 2, të nenit 19, të ligjit nr.18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

parakusht për zhvillimin korrekt dhe sipas standardeve të procesit të edukimit/arsimimit dhe aftësimit fizik të fëmijëve/nxënës, siç është i rëndësishëm dhe vlerësimi i tyre, në bazë të mjeteve dhe pajisjeve të përshtatshme e të përcaktuara në programin mësimor[12]. Arsimimi i fëmijës duhet të zhvillojë potencialin e plotë të personalitetit, dhuntive dhe aftësive mendore e fizike të fëmijës[13]. Po ashtu, investimi në godinat e mjedise shkollore shërben si parapritë dhe masë kundër uljes së numrit të nxënësve në shkolla e shpopullimit të zonave rurale. Edhe në Strategjinë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 evidentohet se "...pavarësisht përmirësimeve, infrastruktura shkollore nuk i plotëson standardet e përcaktuara nga shteti".

Nenet 3, 21 dhe 22, të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar", të ndryshuar, parashikojnë se: *"... arsimi parashkollor dhe ai bazë synojnë zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo fëmije, ushtrimin e rregullave themelore të sjelljes e të higjienës, kultivimin e vlerave, si dhe përgatitjen për arsimin fillor, zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo nxënësi, zotërimin e rregullave të sjelljes dhe kultivimin e vlerave, përkujdesjen për shëndetin, si dhe përgatitjen e mjaftueshme për vazhdimin e arsimit të mesëm të lartë ose për tregun e punës... "*.

Ndërkaq, institucionet shtetërore përgjegjëse duhet të marrin masa konkrete që të inkurajojnë, motivojnë dhe të rrisin cilësinë e arsimimit të fëmijëve/nxënës, nëpërmjet krijimit të kushteve të nevojshme infrastrukturore, si dhe ofrimit të mjeteve të domosdoshme mësimore[14], me qëllim edukimin dhe aftësimin e fëmijëve. Kjo e drejtë themelore dhe e patjetërsueshme shkon paralelisht edhe me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (konkretisht objektivi 4.1 dhe 4.a), i cili pohon rëndësinë e sigurimit të një arsimi gjithëpërfshirës, me cilësi të barabartë dhe promovimin e mundësive të të mësuarit përgjatë gjithë jetës si dhe ndërtimi e përshtattja e mjediseve arsimore që të janë funksionale ndaj fëmijëve, aftësisë së kufizuar dhe gjinisë duke garantuar mjedise të sigurta, jo të dhunshme, gjithëpërfshirëse për një nxënie efektive për të gjithë. Autoritetet shtetërore deri në vitin 2030, duhet të sigurojnë që të gjithë fëmijët/nxënësit të kryejnë arsimin fillor dhe të mesëm falas, të drejtë dhe cilësor, duke çuar në rezultate të rëndësishme dhe efektive të të nxënit[15].

---

[12] "Program mësimor" është dokumenti që përmban synimet, objektivat dhe rezultatet e të nxënit, metodologjitë e të nxënit dhe të vlerësimit për një lëndë ose fushë të caktuar.

[13] Shkronja "a", e nenit 29, e Konventës të OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës.

[14] Shkronja "e", e pikës 3, të nenit 18, të ligjit nr.18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

[15] Problematika e evidentuar nga Avokati i Popullit në vitin 2021 në Raportin sintezë për problematikat e evidentuara në ushtrimin e të drejtës për arsim të fëmijës për t'u arsimuar gjatë pandemisë dhe në vijim të situatës dhe rekomandimet përkatëse, https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20vjetor%20i%20veprimtari%C3%AB%20s%C3%AB%20institucionit%20t%C3%AB%20AP%20p%C3%ABr%20vitin%202021.pdf

Për sa më sipër, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, në interesin më të lartë të tyre, dhe, në zbatim të legjislacionit të mbrojtjes së fëmijës, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në fushën e arsimit dhe, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454/1999 Avokati i Popullit:

R E K O M A N D O N:

- Marrjen e masave të menjëhershme nga Bashkia Dimal për përgatitjen dhe depozitimin pranë sekretariatit teknik në Ministrinë e Arsimit, dhe/ose institucioneve të tjera të përmendura në këtë rekomandim, të dokumentacionit të plotë për rikonstruksionin ose ndërtimin e shkollës "Haxhi Rustem" në fshatin Donofrosë, duke përfshirë projekt-zbatimin, preventivin e detajuar të kostove dhe specifikimet teknike të nevojshme për realizimin e investimit.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454/1999 organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t'i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi!

K O M I S I O N E R

Olta ALIAJ

